

Data: 15.04.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Rikonstruksioni dhe Rivitalizimi i sallës Pedrolo”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): Punime ndërtimi, 45210000-2.

Vlera e fondit limit: : 13,579,666.65 (Trembëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati për zbatimin e saj: 3 (tre) Muaj.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Projekti etj. dhe percaktimi i fondit limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor i cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin em ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote

që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.2.2 Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **6,789,833.32** (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **27,159,333.3** (njëzet e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
- Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.1** Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2** Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- c. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogel se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **6,789,833.32** (gjashtë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pike tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.
- d. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **27,159,333.3** (njëzet e shtatë milion e njëqind e pesëdhjete e nëntë mije e treqind e tridhjetë e tre pikë tre) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave,*

plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (a-b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku qartazi përcaktohet se: **”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave a dhe b, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të

nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos ne kushte te barabarta dhe u jep mundësi te gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund te jene te paplotesuara sipas standartit.

AK ka kerkuar keto dokumenta ne perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP-3A** Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale,veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-4A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-12A** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit.
- **NS-14A** Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim

punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP -3A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Prishje suvatim muri i brendshëm Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace) Prishje shtresa betoni Prishje suvatim i jashtëm Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km Heqje vetratë duralumini ekzistuese Heqje dyer ekzistuese F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham Heqje tavani i varur me kartonxhez Veshje tavani me kartonxhes Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Patinim tavani me stuko Patinim muri me stuko Veshje muri me kartonxhes Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva. Shtrese avullizoluese gjeotekstil Termoizolim solete 10-20 cm me polisterol kompakt Shtrese betoni C 7/10 Shtrese betoni C 16/20 Shtresë moketi Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Veshje kornize llamarine xingat Kasete shkarkimi me llamarine xingat Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	A (0-20 milionë lekë)

		<p>Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25</p> <p>Boje hidroplastike cilesi e larte</p> <p>F.V. Vendorsje dyersh me doreze antipantik</p> <p>F.V. Perde Roller kundra diellit, 100%, polyster e bardhe duke perfshire motorin, telekomanden e cdo pajisje tjeter e nevojshme per instalim</p> <p>Veshje muri me melamine</p> <p>F.V. Podium me konstrukcion metalik dhe veshje laminat etj</p>	
NS-4 A	<p>Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.</p>	<p>F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>Veshje tavani me kartonxhes</p> <p>Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25</p> <p>Patinim tavani me stuko</p> <p>Patinim muri me stuko</p> <p>Veshje muri me kartonxhes</p> <p>Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m</p> <p>Veshje muri me polisterol te thjeshte t=5cm rrjete+suva.</p> <p>Termoizolim solete 10-20 cm me polisterol kompakt</p> <p>Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm</p> <p>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama</p> <p>Veshje kornize llamarine xingat</p> <p>Kasete shkarkimi me llamarine xingat</p> <p>Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100</p> <p>Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25</p> <p>Boje hidroplastike cilesi e larte</p> <p>F.V. Vendorsje dyersh me doreze antipantik</p> <p>F.V. Perde Roller kundra diellit, 100%, polyster e bardhe duke perfshire motorin, telekomanden e cdo pajisje tjeter e nevojshme per instalim</p> <p>Veshje muri me melamine etj.</p>	A (0-20 milionë lekë)
NS-12A	<p>Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiot elefoni TV.</p>	<p>F.V. Tub plastmasi Ø 22-26mm</p> <p>F.V. Priza shuko universal</p> <p>F.V. Kutu suport pllaket 4 mod</p> <p>F.V. Çeles 1 polar 220V 10A</p> <p>F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm</p>	A (0-20 milionë lekë)

		<p>F.V kapak kanaline Zn 200x75 birezuar dhe aksesore</p> <p>F.V Kanaline Zn 200x75 birezuar</p> <p>F.V Kabell Me Izolacion HEPR me emetim te reduktuar gazrash , pa Halogjen ,jo perhapes zjarri FG16OM161 S=3x2.5mm2</p> <p>F.V Kabell Me Izolacion HEPR me emetim te reduktuar gazrash , pa Halogjen ,jo perhapes zjarri FG7OM1 S=5x10mm2</p> <p>F.V Kabell Me Izolacion HEPR me emetim te reduktuar gazrash , pa Halogjen ,jo perhapes zjarri FG7OM1 S=5x16mm2</p> <p>F.V.Torrete 8 module</p> <p>F.V Kabell Me Izolacion HEPR me emetim te reduktuar gazrash , pa Halogjen ,jo perhapes zjarri FG7OM1 S=3x1.5mm2</p> <p>F.V Ushqyes per shirit ndricimi 100W 24 V</p> <p>F.V Shirit ndricimi LED 10W+fthohes</p> <p>Montim ndricues Tip Spot inkaso D=20cm</p> <p>F.V. Kabllo rrjeti kompjuterik, Tip UTP-cat6 , 250MHz Flame retardant</p> <p>F.V. Kabllo Audio R/N 2x1.5 CU</p> <p>F.V. Kuti shperndarese PT-7</p> <p>F.V. Priza rrjeti kompjuterik tip RJ-45, cat 6, UTP</p> <p>F.V. Drejtues kabllosh</p> <p>F.V. Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, L=2 m</p> <p>F.V. Suport 8 priza PDU 19" 1HE 16A</p> <p>Montim Rack, 12 HU , kompletuar me aksesore dhe dere xhami</p> <p>Montim Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6e</p> <p>Montim Grup ventilatoresh me 2 FAN per rack + Panel Komandimi Ventilator 12"</p> <p>Montim kuadri elektrik , sipas skemes</p> <p>F.NdricuesTip Spot inkaso D=20cm</p> <p>F.Rack, 12 HU , kompletuar me aksesore dhe dere xhami</p> <p>F. Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6e</p> <p>F. Grup ventilatoresh me 2 FAN per rack + Panel Komandimi Ventilator 12"</p> <p>Kuadri elektrik etj.</p>	
--	--	---	--

NS-14A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	<p>F.V Tub bakri i prodhuar sipas standardit EN 12735-1 i paraizoluar me polietileni të zgjeruar me qeliza të mbyllura me dimensione të rregullta dhe i shpërndarë në mënyrë uniforme (UNI EN 14114) 9,52 mm</p> <p>F.V Tub bakri i prodhuar sipas standardit EN 12735-1 i paraizoluar me polietileni të zgjeruar me qeliza të mbyllura me dimensione të rregullta dhe i shpërndarë në mënyrë uniforme (UNI EN 14114) 12,7 mm</p> <p>F.V Tub bakri i prodhuar sipas standardit EN 12735-1 i paraizoluar me polietileni të zgjeruar me qeliza të mbyllura me dimensione të rregullta dhe i shpërndarë në mënyrë uniforme (UNI EN 14114) 15,9 mm</p> <p>F.V Tub bakri i prodhuar sipas standardit EN 12735-1 i paraizoluar me polietileni të zgjeruar me qeliza të mbyllura me dimensione të rregullta dhe i shpërndarë në mënyrë uniforme (UNI EN 14114) 19,05 mm</p> <p>F.V Tub bakri i prodhuar sipas standardit EN 12735-1 i paraizoluar me polietileni të zgjeruar me qeliza të mbyllura me dimensione të rregullta dhe i shpërndarë në mënyrë uniforme (UNI EN 14114) 22,2 mm</p> <p>F.V Tub bakri i drejtë SCT pa veshje 25.4 mm, kompletuar me gjithë armofleks me trashesi 13 mm.</p> <p>F.V Tub bakri i drejtë SCT pa veshje 28,6 mm, kompletuar me gjithë armofleks me trashesi 13 mm.</p> <p>F.V Komplete degezuesish "Y" model VBP-01REA per lidhjen e moduleve te pajisjeve te jashtme me linjen kryesore te tubacioneve qe lidhen me pajisjet e brendeshme.</p> <p>F.V Komplete degezuesish "Y" model VBP-02REA per lidhjen e moduleve te pajisjeve te jashtme me linjen kryesore te tubacioneve qe lidhen me pajisjet e brendeshme.</p> <p>F.V Komplete degezuesish "Y" model VBP-04REA per lidhjen e moduleve te pajisjeve te jashtme me linjen kryesore te tubacioneve qe lidhen me pajisjet e brendeshme.</p>	A (0-20 milionë lekë)
--------	--	--	-----------------------

		<p>F.V Kabull komunikimi 3x1mm per pajisjete e brendeshme me pajisjet e jashtme, i skermuar.</p> <p>F.V Kablo multipolar bakri, tip FG16OM16 S=3x2.5 mm²</p> <p>F.V Tub PP 32 per largimin e kondensatit, I kompletuar me gjithe Brryla, "T" dhe asesoret e nevojshem per montim.</p> <p>F.V Lllamarin zingato Z270, S=0.6-1.2 mm sipas percaktimeve ne tabelen e dhen ne projekt. Per prodhimin e kanaleve te ajrit kuadratik ose rrethore, kompletuar me gjithe llyerje me boje antikondense. Kompletuar me gjithe rakorderi. Per kanalet e ajrit te aspirimit te</p> <p>F.V Grila me fleta fikse shiu 500x300 kompletuar me gjithe aksesoret e nevojshem per montim.</p> <p>F.V Grila kondicionimi 290x18 Kompletuar me gjithe aksesoret e nevojshem per montim</p> <p>F.V Difuzor DN 200 mm</p> <p>F.V Tub I Brinjezuar (Corrugato) D200 kompletuar me aksesoret per montim.</p> <p>F.V Tub I Brinjezuar (Corrugato) D204 kompletuar me aksesoret per montim.</p> <p>F.V Komplet me konstruksione metalike per instalimin e pajisjeve te brendeshme, Profile metakile, UPA betoni, Prixhioner, etj.</p> <p>F.V Komplete rakorderie prej bakri per lidhjen e pajisjeve me tubacionet e bakrit.</p> <p>F.V Komplete rakorderie plastike per lidhjen e pajisjeve me tubacionet e e largimit te kondenses.</p> <p>F.V Mbushje me gaz Refrigerant R410A, kompletuar me gjithe Vakum te linjave.</p> <p>F.V Kabull 1 polar Bakri FG16R16 S=1x35mm</p> <p>F.V Kabull 1 polar Bakri FG16R16 S=1x25mm</p> <p>F.V Kabull multi polar Bakri FG16OR16 S=5x16mm</p> <p>Montim Pajisje e jashtme VRF, Full DC Inverter CONTINUOUS HEATING -Fuqia ne Ftohje:80 kW -Fuqia ne Ngrohje:80 kW -Performanca,EER/COP:3.35/4.12 -Fuqia Elektrike C/H:35.16/32.20 -Furnizim</p>	
--	--	---	--

		<p>Montim Njesi e brendeshme VRF, tip Kanalore. - Kapaciteti termik Ngrohje:11.2 kW - Kapaciteti termik Ftohje:13 kW - Fryrja e Ajrit (H/M/L):(2000/1700/1400) m3/h - Niveli i Zhurmave:(38/35/32) dB (A) - Dime</p> <p>Montim Njesi trajtimi ajri, Rikuperator Nxehtesie - Seksioni i Rikuperimit te nxehtesise Fryrja Derg/Rikthim: 2000 m3/h Renia e presionit:296 Pa Rendimenti :75 % Fuqia elektrike:3.2 kW Grupi i filtrave:</p> <p>F. Njesi trajtimi ajri, Rikuperator Nxehtesie - Seksioni i Rikuperimit te nxehtesise Fryrja Derg/Rikthim:2000 m3/h Renia e presionit 296 Pa Rendimenti :75 % Fuqia elektrike: 3.2 kW Grupi i filtrave:</p> <p>F. Njesi e brendeshme VRF, tip Kanalore. - Kapaciteti termik Ngrohje:11.2 kW - Kapaciteti termik Ftohje:13 kW - Fryrja e Ajrit (H/M/L): (2000/1700/1400) m3/h - Niveli i Zhurmave:(38/35/32) dB (A) - Dimension</p> <p>F. Pajisje e jashtme VRF, Full DC Inverter CONTINUOUS HEATING - -Fuqia ne Ftohje: 80 kW -Fuqia ne Ngrohje:80 kW - Performanca,EER/COP:3.35/4.12 -Fuqia Elektrike C/H:35.16/32.20 etj.</p>	
--	--	--	--

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtuesi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më

të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP3,NS4** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit**
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS12** eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Mekanik.**
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS14** eshte e nevojshme prezencat e **një Inxhinieri Elektrik.**

2.3.5 Një punësim minimalisht prej **15** (pesëmbëdhjetë) punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoresh, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoresh të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 15 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elemente të strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtoresh që kërkohej për realizimin e punimeve është min 15 punonjës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK		NUMRI
1	Elektracist	2
2	Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje	1
3	Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)	1
4	Suvatues	2
5	Specialist gipsi	2
6	Bojaxhi	2
7	Shofer	1

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.3.6/1 Për punonjesit shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi . *(Në rastin kur punonjësit shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet

teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në kater elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.7 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e

punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kerkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet te jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve **SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën **SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001:2018 e përditësuar**, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese ISO-t në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”- b” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë*”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit*”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe

sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.8 gërma “a”-“b”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve

2.3.9 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

NR	TABELE PERMBLEDHESE PER MAKINERITE E NEVOJSHME PER PUNIMET		
	Makineri/Pajisje	Njesia	Nr
1	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	cope	1
2	Elektroorgano	cope	1
3	Elektrobetoniere/Betoniere	cope	1
4	Gjenerator / Motogjenerator	cope	1
5	Pompe Suvatimi	cope	1
6	Depozite uji min ne 1000 litra	cope	1
7	Vibrator betoni	cope	1
8	Matrapik	cope	1
9	Pomp Uji	cope	1

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) leje qarkullimi; b) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); c) siguracion mjeti (i vlefshëm);
 - b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse e Qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm);
- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.

Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standardeve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standardeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike , për realizimin e objektit prokurimi, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “**Universiteti Bujqësor Tiranës**”, dhe projekti i hartuar nga projektuesi për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “*Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise*”, i ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT